



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ÇËRRIK

Nr. 662 Prot.

Çërrik më: 21/02/2018

VENDIM
Nr. 270, datë 20.02.2018

**“PËR NJË NDRYSHIM NË V.K.B –NË NR.249, DATË 19.12.2017 “PËR
MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË ÇËRRIK PËR VITIN 2018”.**

Në zbatim të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008, “Per Menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”i ndryshuar, ligjit nr. 109/2017, “Për Buxhetin e vitit 2018”, Ligjit 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Udhezimit të posaçëm nr.24, datë 29/12/2017 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”. Mbas rakordimit përfundimtar të Fondëve që trashëgohen në vitin 2018, me propozim të Grupit për Menaxhim Strategjik, Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 20.02.2018,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimet në Vendimin e Këshillit Bashkiak, nr.249, datë 19/12/2017 “Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Çërrik për vitin 2018” si më poshtë:

1.1- Të miratojë shtesë në burimin e të Ardhurave (Fondet e trashëguara nga viti 2017) në shumën 20522096.78 lekë.

1.2- Të miratojë shtesën e shpenzimeve për vitin 2018, në vlerën 20522096.78 lekë.

2. Të miratojë totalin e të Ardhurave për vitin 2018, në vlerën 384,022,434.78 lekë, sipas tabelës nr.1 pjesë përberëse e këtij vendimi.
3. Të miratojë totalin e shpenzimeve për vitin 2018, në vlerën 384,022,434.78 lekë, sipas tabelave Nr.2; 2/1; 2/2; 2/3,3, pjesë përberëse e këtij vendimi.

- 2- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar.
3-Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan.

Miratohet më datë 20.02.2018

Shpallet më datë 21.02.2018

Kryetari i Këshillit të Bashkisë

Jetmir LAROSHI



Dixhitalizuar nga Qendra për Çështjet e Informimit Publik INFOCIP
www.infocip.org
www.vendime.al